



MEKANIZMI VLERËSUES
I BE-SË PËR „ÇËSHTJET
FUNDAMENTALE PËRPARA TË GJITHAVE”:
REZULTATET DHE SFIDAT

VLERËSIMI NË KOSOVË



MEKANIZMI VLERËSUES I BE-SË PËR “ÇËSHTJET
FUNDAMENTALE PËRPARA TË GJITHAVE”:
REZULTATET DHE SFIDAT



Koordinuar nga:

Instituti për Politika Evropiane (EPI) – Shkup

Publikuesi:

Grupi për Juridike dhe Politike – Prishtina

Autore:

Albana Rexha

Projektimi Grafik:

Relativ - Skopje

Prishtinë, Shkurt 2018



European Fund for the Balkans

Kjo përmbledhje e shkurtër politikash është prodhuar si pjesë e hulumtimit në kuadër të Programit Rajonal për Politika 'Mendo dhe Ndërlidh 2017' dhe i bashkë financuar nga FShH (Fondacionet për Shoqëri të Hapura). Pikëpamjet e prezantuara në këtë përmbledhje të politikave janë pikëpamjet e autorit dhe nuk e reflektojnë domosdoshmërisht Pozicionin e Fondit Evropian për Ballkanin dhe atë të Fondacioneve për Shoqëri të Hapura.



PËRMBAJTJA



MEKANIZMI VLERËSUES I BE-SË PËR “ÇËSHTJET FUNDAMENTALE PËRPARA TË GJITHAVE”:	
REZULTATET DHE SFIDAT.....	4
HYRJE	5
METODOLOGJA	7
ANALIZË E MEKANIZMAVE VLERËSUES TË PËRZGJEDHUR	9
GJYQËSORI: SISTEMI I KARRIERËS PËR GJYQTARËT I BAZUAR NË MERITË.....	10
GJYQËSORI: REFORMAT E AKADEMISË SË GJYQËSORIT	10
KUNDËR-KORRUPSIONI: SISTEM PËR KARRIERË TË BAZUAR NË MERITË PËR SHËRBYESIT CIVILË	11
TË DREJTAT THEMELORE: REGJISTRIMI I TË DHËNAVE PËR ADRESIMIN E FRIKËSIMIT TË MEDIAVE; SULMEVE NDAJ GAZETARËVE; PAVARËSISË SË MEDIAVE.....	11
TË DREJTAT THEMELORE: ZBATIMI I LIGJIT PËR NDALIM TË DISKRIMINIMIT	12
AZILI: BASHKËRENDITJA E LIGJIT TË AZILIT ME ACQUIS-NË E BE-SË	12
KUFIJTË E JASHTËM DHE SHENGENI: PLANE SPECIFIKE KUNDËR-KORRUPSIONIT; OFRIMI I NDJEKJES ADEKUATE TË RASTEVE TË ZBULUARA; BASHKËPUNIM NË KUFIJ	13
LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR: ROLI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS DHE I MEKANIZMAVE MBIKËQYRËS NË FUNKSION; REGJISTRIMI I TË DHËNAVE FILLESTARE PËR HETIMET E KRIMIT TË ORGANIZUAR.....	13
DISKUTIMI I REZULTATEVE.....	14
Aneksi 1	16






MEKANIZMI VLERËSUES I BE-SË PËR „ÇËSHTJET FUNDAMENTALE PËRPARA TË GJITHAVE”: REZULTATET DHE SFIDAT



Ky raport, pjesë e një projekti rajonal, studion efektivitetin e sistemit vlerësues të BE-së për çështje të përzgjedhura politikash në kuadër të Kapitullit 23 dhe 24, që fokusohet në rastin e Kosovës. Shembulli është përzgjedhur duke ndjekur një plan të mekanizmave vlerësues që janë të përbashkët apo të ngjashëm në mesin e gjashtë Vendeve të Ballkanit Perëndimorë që aspirojnë anëtarësimin në BE. Kjo analizë përfaqëson një përpjekje fillestare madhore për të vlerësuar në mënyrë kritike shkallën në të cilën janë arritur objektivat dhe shtrirjen, deri në ç’masë janë zgjidhur problemet e shënjestruara, për të avancuar më tej në procesin e anëtarësimit në BE.



HYRJE



Në qershor 2018, do të bëhen pesëmbëdhjetë vite që nga mbajtja e Samitit të Selanikut –“Deklaratës së BE-së për Ballkanin Perëndimor”, ku rajonit iu ri-theksua prospekti për t’iu bashkuar Unionit.¹

Procesi i integritimit është duke u zvarritur, ndërkohë që, Kosova mbetet ende jashtë regjimit pa viza. Para gjashtë vitesh Kosovës i është dhënë Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave, i cili përcakton reformat dhe kushtet që duhet të plotësohen me qëllim të kualifikimit për udhëtim pa viza në hapësirën e Shengen. Kjo është konsideruar në të njëjtën kohë si një angazhim serioz i cili ka ri-konfirmuar mbështetjen e Bashkimit Evropian poashtu edhe si motivimi më i madh që i është dhënë vendit në lidhje me zbatimin e reformave. Prandaj, edhe pse nxjerrja e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave nuk ka themeluar ndonjë marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian, ka shënuar një udhëkryq të marrëdhënieve të shtetërore me BE-në.

BE-ja ka themeluar një marrëdhënie kontraktuale me Kosovën vetëm përmes Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) e cila ka hyrë në fuqi në Prill 2016, ndërkohë që është nënshkruar në vitin 2015.² MSA-ja përfaqëson kornizën politike të BE-së dhe është projektuar për të shtuar bashkëpunimin bilateral dhe rajonal, dhe është themeluar për të ndihmuar vendin që të bëjë reformat e nevojshme. Për këtë qëllim, qeveria ka miratuar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA) si një dokument kyç kombëtar për politika. PKZMSA përfshin një kornizë afat-mesme të të gjitha reformave të nevojshme që rrjedhin nga MSA-ja.³ Për të ofruar një motivim të ri dhe për të përcaktuar prioritetet në procesin e zbatimit të MSA-së Komisioni Evropian nisi Dialogun e Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe – Agjenda e Reformës Evropiane (ARE).⁴ Prandaj, dy dokumentet kombëtare të politikave, a) PKZMSA dhe b) ARE, i shërbejnë vendit që të nisë rrugën e progresit për të avancuar në rrugëtimin e tij drejt BE-së.

Viti 2012, e poashtu edhe viti 2015, përfaqësojnë një fazë kritike⁵ për marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian. Viti 2012 është përzgjedhur si viti fillestar për këtë analizë, qëllimi i të cilës është që të vlerësojë efektivitetin e mekanizmit vlerësues⁶ të vënë në funksion në politikën kushtëzuese të BE-së. Kështu që, tetë mekanizma vlerësues (të elaboruar më poshtë) do të analizohen gjatë periudhës 2012 deri 2017. Kjo nënkupton se, do të jenë në dispozicion, të dhëna tjera shtesë në lidhje me shkallën e zbatimit të secilit mekanizëm vlerësues dhe shtrirjen deri ku janë zgjidhur problemet e shënjestruara dhe kjo do të ofrojë një analizë më të thellë dhe të besueshme. Të dhënat në lidhje me secilin mekanizëm vlerësues janë gjurmuar në kohë (që nga 2012) në dokumentet për zgjerim të tilla si raportet e KE-së për vendin, udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe strategjinë e zgjerimit të BE-së (e cila është elaboruar më tej në metodologjinë).

Pjesa në vijim do të diskutojë metodologjinë e analizës dhe mekanizmat e përzgjedhur, ndërkohë që tetë pjesët në vijim do të ofrojnë një vlerësim kritik të secilit mekanizëm të përzgjedhur përsa i përket zbatimit dhe efektivitetit të tij. Pjesa përfundimtare do t’i ofrojë KE-së rekomandime të bazuara në prova për të rritur efektivitetin e mekanizmit vlerësues, si dhe qeverisë së Kosovës për forcimin e mekanizmit monitorues.

1 Komisioni Evropian dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian (2003). “Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor”. Bashkimi Evropian me rastin e Samitit BE-ShBA, në Washington. Në dispozicion në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/er/76323.pdf

2 Komisioni Evropian, Deklaratë për Shtyp: “Marrëveshja për Stabilizim Asociim ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës hyn në fuqi”. Bruksel, 1 Prill 2016. Në dispozicion në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1184_en.htm Këshilli i Evropës, Deklaratë për Shtyp. “Marrëveshja për Stabilizim Asociim ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës u nënshkrua”, 27 Tetor 2015. Në dispozicion në: <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-stabilisation-association-agreement/>

3 Ministria e Integritimit Evropian, Republika e Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim – PKZMSA në dispozicion në: <http://www.mei-ks.net/en/national-program-for-implementation-of-npisaa>

4 Komisioni Evropian, Deklaratë për Shtyp. “Johannes Hahn me rastin e nisjes së Agjendës së Reformës Evropiane”. 11 Nëntor 2016. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2014-2019/hahn/announcements/johannes-hahn-occasion-launch-european-reform-agenda_en

5 Faza kritike i referohet një viti i cili përfaqëson një pikë kthese ose një udhëkryq i marrëdhënieve të Kosovës me Bashkimin Evropian

6 Për qëllim të kësaj analize ne i përkufizojmë mekanizmat vlerësues si mjete matëse që përmirësojnë cilësinë e negociatave duke ofruar stimulum/motivime për vendët kandidatë në mënyrë që të ndërmarin reformat e nevojshme në një fazë të hareshme – këto mekanizma janë të matshëm dhe të ndërlidhur me elementë kyç të kapitullit të Aquis. Burimi: COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL, Enlargement Strategy and Main Challenges 2006 – 2007, Brussels, 2006.

METODOLOGJA

Në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti i mekanizmit vlerësues, ky proces hulumtimi është bazuar në mostra, krahasime, monitorim të zbatimit dhe vlerësim të vet mekanizmave vlerësues. Për qëllim të një analize të thellë, ky hulumtim është bërë në mostra të mekanizmave vlerësues nga Kapitulli 23 dhe 24.

Përzgjedhja e mostrave të mekanizmave vlerësues është bërë sipas hapave në vijim: Mekanizmat e përkohshëm dhe ata fillestarë të cilët janë përcaktuar për Serbinë dhe Malin e Zi në Kapitujt 23 dhe 24 janë marrë si baza dhe janë kategorizuar në një tabelë, varësisht llojit të veprimit që kërkohet:

Miratim i një dokumenti politikash (Pol); Miratim legjislativ (Leg); Zbatim: Themelimi/fuqizimi i një organi (B); Trajnim (T); Themelimi i sistemeve të TIK (TIK); Bashkëpunim (Bpn); Regjistrim i të dhënave (Regj); Tjerë (T).

Më tej, ekipi hulumtues përzgjedhi një mostër të 8 mekanizmave vlerësues që do të analizohen në thellësi. Në këtë proces janë marrë parasysh faktorët në vijim: relevanca dhe rëndësia e problemit si nga perspektiva kombëtare poashtu edhe nga ajo rajonale; fazat kritike të përbashkëta dhe shpërndarja e barabartë e kategorive dhe veprimeve siç përcaktohet nga mekanizmat vlerësues; disponueshmëria e informatave relevante për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmave vlerësues. Ndërkohë Mali i Zi dhe Serbia kanë gjurmuar mekanizmat vlerësues në raportet e tyre Verifikuese dhe dokumentet e tyre për Qëndrim të përbashkët si vende që i kanë hapur negociatat, vendet e tjera poashtu kanë gjurmuar në mënyrë adekuate mekanizmat vlerësues në dokumentet për zgjerim (raportet e BE-së për vendet; udhërrëfyes; Strategji të zgjerimit). Kështu që, janë përzgjedhur mekanizmat në vijim:

Kapitulli 23	
•Sistem karriere i bazuar në meritë për gjyqtarët	Regjistrim i të dhënave/provave (Track record)
•Reformat e Akademisë Gjuqësore	Themelimi/fuqizimi i një institucioni
•Sistem karriere i bazuar në meritë për nëpunësit civilë	Të tjera / Evidentimi i të dhënave/provave (Track record)
•Regjistrimi i provave për trajtimin e rasteve të kërcënimit të medias; sulmet ndaj gazetarëve; pavarësia e medias	Evidentimi i të dhënave/provave (Track record)/fuqizimi i një institucioni
•Zbatimi i Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"	Miratimi i legjislativ (Leg)/ Miratimi i një dokumenti politikash (Pol)
Kapitulli 24	
•Ligji për azilin i përafuar me acquis të BE-së	Miratimi i legjislativ (Leg)
•Plane specifike anti-korrupsion; ndjekja e mëtejshme e rasteve të zbuluara; bashkëpunimi ndërkufitar	Regjistrim i të dhënave/provave /bashkëpunim
•Roli i shërbimeve të inteligjencës dhe i mekanizmave mbikëqyrës në funksion; themelimi i provave fillestare mbi hetimin e krimit të organizuar	Të tjera/ Regjistrim i të dhënave/provave (Track record)

Mbledhja e të dhënave për të gjitha shtetet ka konsistuar në analizë në zyrë dhe intervista me palë të interesit. Së pari, dokumentet kyçe⁷ në lidhje me procesin e pranimit në BE janë analizuar për identifikim, marrje të mostrave dhe analizë të mekanizmave vlerësues. Për më tepër, për qëllim të vlerësimit të efektiviteti të mekanizmave vlerësues studimi përdor vlerësimet e raporteve të vet ekipit hulumtues të angazhuar, por poashtu raporte të organeve tjera ndërkombëtare që kanë monitoruar zhvillimet në fushat e studiuara të politikave. Kjo përfshin Raportet e Progresit të Shteteve dhe dokumente strategjike për zgjerim nga Komisioni Evropian, raporte SIGMA, Raporte të OSBE-së, Raporte të departamentit të Shteteve të Bashkuara, Raporte të organeve të KB, si dhe Mekanizmat Monitorues të Këshillit të Evropës. Kur ka qenë e mundur, analiza e gjendjes aktuale përfshin një rishikim të indikatorëve kuantitativë në dispozicion të tillë si renditja e Shteteve në Tranzicion nga Freedom House. Së dyti, janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësuesit e delegacionit të BE-së dhe/


7 Qëndrimi i Përbashkët I BE-së për kapitujt 23 dhe 24 (për vendet në negociata të anëtarësimit); Raportet e KE-së për vendin – dokumentet e punës të stafit (analizim i fushave në të cilat përmenden mostrat e mekanizmit vlerësues të BE-së); Strategjia për Zgjerim – Komunikimi I Komisionit (analizim i fushave në të cilat përmenden mostrat e mekanizmit vlerësues të BE-së); Kornizat e negociatave me BE-në; Raportet verifikuese të KE-së; Udhërrëfyes, konkluzione të "dialogëve të nivelit të lartë" dhe instrumente tjera që përcaktojnë kushtet për progres të mëtejshëm në procesin e anëtarësimit; Dokumentet përmes të cilave vendet e përfshira i përgjigjen standardeve të përcaktuara nga mekanizmat vlerësues (Planet Kombëtare); Planet e veprimit të paraqitura Komisionit Evropian nga autoritete relevante, Procesverbalet e Këshillit për Stabilizim dhe Asociim, Nën-komitetet për Drejtësi dhe komitetet e Punëve të Brendshme.

ose të Shteteve Anëtare të BE-së, si dhe me përfaqësues të institucioneve kombëtare të ngarkuara me detyrën e anëtarësimit në BE dhe në zbatimin e detyrave të përcaktuara në mekanizmat vlerësues. Fokusi në Stafin e BE-së dhe në shërbyesit civilë vendorë erdhi si rezultat i rolit të rëndësishëm që këta individë luajnë si në krijimin e mekanizmave në nivel të BE-së, poashtu edhe në lidhje me veprimet vendore për arritjen e objektivave respektive përcaktuar në këto mekanizma. Në rastin e Kosovës, janë zhvilluar intervista me 2 Janar, 2018 deri me 31 Janar, 2018 dhe kanë përfshirë, Ombudpersonin, Drejtorin Lijgor – Ministria e Administratës Publike, Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, Qendrën Kosovare për Studime Sigurie, ekspert për liberalizimin e vizave – OShC, dhe Instituti Demokratik i Kosovës.

Analiza e mekanizmave vlerësues është bërë përmes futjes së të dhënave të mbledhura në një formë të paracaktuar⁸ e cila konsistoi në disa hapa. Së pari, ka gjurmuar futjen dhe evoluimin e mekanizmit vlerësues të paktën pesë vitet e fundit, ose që nga etapa e fundit kritike në dokumentet e BE-së. Së dyti, hulumtuesit e vlerësuan gjendjen aktuale përmes rishikimit të dokumenteve, duke përfshirë edhe të gjeturat e indikatorëve kuantitativë në dispozicion në fushën specifike të politikave. Së fundmi, janë nxjerrë konkluzione për efektivitetin e mekanizmave vlerësues në fushën specifike të politikave deri më tani. Informacioni nga format është përdorur më tej për të zhvilluar analizën që i është bërë vendit nga secili partner.



ANALIZË E MEKANIZMAVE VLERËSUES TË PËRZGJEDHUR



GJYQËSORI: SISTEMI I KARRIERËS PËR GJYQTARËT I BAZUAR NË MERITË

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është organi qeverisës i gjyqësorit, përgjegjës për rekrutimin, zbatimin e masave disiplinore dhe vlerësim të performancës për gjyqtarë. Parimet për rekrutim të bazuar në meritë dhe vlerësim të performancës janë në funksion dhe janë të mbrojtura në dokumentet e politikave; sido që të jetë, implementimi është i dobët. Sipas një eksperti për sundim të ligjit nga shoqëria civile, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve bëhet në mënyrë kalimtare, është krejtësisht formal dhe pa ndonjë pasojë të vërtetë në promovimin apo uljen në detyrë të gjyqtarëve.⁹ Ai nënvizon se “një mungesë e qartë e integritetit dhe një mentalitet i varfër” është prezente në mesin e gjyqtarëve vendorë.¹⁰

Dimensioni tjetër i një sistemi për karrierë të bazuar në meritë për gjyqtarët është rekrutimi. Ky proces, në mes tjerash¹¹ është i parashikuar me rregulloren nr. 14/2016 për rekrutim dhe vlerësim të gjyqtarëve. Sipas rregullores, KGJK-ja administron testin pranues për gjyqtarët; gjithsesi, ky test nuk menaxhohet në mënyrë të besueshme. Në Nëntor 2016, KGJK-ja i uli kriteret pranuese për gjyqtarët e rinj në bazë të ofrimit më shumë hapësire për gjyqtarë nga mesi i grave dhe grupeve të minoritetit.¹² Ky vendim konsiderohet “një pengesë në zbatimin e sistemit të karrierës të bazuar në meritë për gjyqtarët” nga këshilltari për sundim të ligjit në Ambasadën e Mbretërisë së Holandës.¹³ E njëjta pikëpamje mbahet nga eksperti për sundim të ligjit i cili monitoron punën e KGJK-së dhe konsideron se rekrutimi i bazuar në meritë reflektohet vetëm në dokumente.¹⁴ Mbi të gjitha, ulja e kriterëve pranuese për gjyqtarët e rinj që hyjnë në sistem ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e punës dhe efektivitetin e tërësisë së sistemit të drejtësisë.

Për më tepër, raporti i KE-së për vendin gjithashtu shënon se “niveli i profesionalizmit dhe i kompetencës është ende një çështje shqetësuese”.¹⁵ Rekomandimet e KE-së në lidhje me vënien në funksion të një sistemi rekrutimi të bazuar në meritë për gjyqtarët datojnë që nga viti 2012. Që nga ajo kohë, janë miratuar shumë ligje për të siguruar një sistem të bazuar në meritë për gjyqtarët, por si u tha ma sipër mungon zbatimi i tyre. Më tej, perceptimi publik drejt pavarësisë gjyqësore vazhdon të jetë i ulët në mesin e popullatës së vendit. Rreth 60% e atyre që janë anketuar mendojnë se sistemi i drejtësisë nuk është përmirësuar gjatë viteve të fundit.¹⁶ Kjo mund të shpjegohet pjesërisht në bazë të mungesës së vendimeve përfundimtare në rastet kur politikanë të profilit të lartë janë nën hetim.

GJYQËSORI: REFORMAT E AKADEMISË SË GJYQËSORIT

Nuk ka mekanizma vlerësues specifike në lidhje me Reformat e Akademisë së Gjyqësorit para vitit 2015, Ligji Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë hyri në fuqi, duke e transformuar Institutin Gjyqësor të Kosovës në Akademinë e Drejtësisë (në tekstin në vijim akademia).¹⁷ Nevoja për të hartuar këtë ligj është identifikuar në takimin SAPD të Komitetit Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri.¹⁸ Nuk ka rekomandime tjera konkrete në lidhje me Akademinë, përveç kërkesave nga KE për ofrim të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe që të alokohet më shumë buxhet për të fuqizuar sistemin e drejtësisë si tërësi. Akademia është përgjegjëse për të ofruar trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë duke u bazuar në kurrikulën vjetore të trajnimit të përgatitur bashkërisht nga KGJK-ja. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Akademia në vijim të një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave për trajnim.¹⁹ Gjithsesi, sipas një eksperti për SeL të një OShC-je, Akademia ofron trajnime ad-hoc për gjyqtarë dhe prokurorë.²⁰ Në çdo raport të KE-së për vendin ka vetëm një paragraf të vogël në lidhje me Akademinë e Drejtësisë²¹, për faktin që kjo akademi konsiderohet “një punë në progres e sipër”.²²

9 Intervistë me Ehat Miftaraj, ekspert për SeL OShC. 30 Janar 2018.

10 Po aty

11 Këshilli Gjyqësor i Kosovës .Rregullore Nr.17 për ndryshimin e rregullores (Nr.14/2016) për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (0912016) për procedurat e zgjedhjes, emërimit, vlerësimit, pezullimit dhe shkarkimit tëv kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës. Gjindet në <http://www.gjyqesori-rks.org/en/legislation/list?id=2&type=4&year=2016>

12 Kallxo. (2016). “KGJK ul kriterin për <http://kallxo.com/kgjk-ul-kriterin-per-pakicat-dhe-grate/>

13 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare për Politika për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.

14 Intervistë me Ehat Miftaraj, CSO ekspert për SeL OShC. 30 Janar 2018. Sipas tij, ka pretendime që testet për pranim u shpërndahen para ditës së testit atyre njerëzve të cilët ata duan që të hyjnë në sistemin e gjyqësorit. Sipas asaj, përzgjedhja e gjyqtarëve nuk bëhet bazuar në kornizën ligjore dhe politike, por e bazuar në lidhjet me politikën dhe marrëdhëniet të cilat lënë jashtë rekrutimin e bazuar në aftësi, njohuri dhe kapacitete.

15 Komisioni Evropian (2016).Raporti mbi vendin për Kosovën.

16 ROLPIK -IndeksiPërformancësSundimittëLigjtnëKosovë” (2017). Grupi për StudimeLigjore dhe Politike. Gjindet në <http://www.rolpik.org/permireshimii-gjyqesorit/?muaji=Qershor&viti=2017>

17 Akademia e Drejtësisë. Pjesa Në Lidhje me Ne. Gjendet në <https://ad.rks-gov.net/en/about-us>

18 Procesi i Dialogut BE- Kosovë për Stabilizim Asociim (PDST). Komiteti Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri. Bruksel, 27-29 Janar 2015.

19 Akademia e Drejtësisë së Kosovës. Gjindet në <https://ad.rks-gov.net/>

20 Intervistë me Ehat Miftaraj, Ekspert i OShC në Sundim të Ligjit, 30 Janar 2018. Sipas tij KGJK-ja dhe KPK-ja nuk kanë treguar interes në identifikimin e nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kështu nuk bashkëpunojnë lehtësisht me Akademinë e Drejtësisë për të përgatitur bashkërisht kurrikulën e trajnimit

21 Ju lutem verifikoni paragrafin “Cilësia e Drejtësisë” në secilin raport mbi vendin dhe ju do të gjeni gjendjen aktuale dhe rekomandimet në lidhje me Akademinë e Drejtësisë.

22 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit në Ambasadën e Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.

KUNDËR-KORRUPSIONI: SISTEM PËR KARRIERË TË BAZUAR NË MERITË PËR SHËRBYESIT CIVILË

Mekanizmi vlerësues kundër – korrupsionit, më saktësisht sistemi për karrierë të bazuar në meritë për shërbyesit civilë, është përmendur specifikisht së pari në Raportin e Komisionit Evropian (KE) të 2015 për Progresin e Kosovës. Gjithashtu, kërkesat e KE-së për një administratë publike efikase e efektive mund të datojnë shumë vite para 2015. Ndërkohë që qasja strategjike për një reformë sektoriale nga qeveria filloi me hartimin e strategjisë së parë për Reformën e Administratës Publike (2010-2013) dhe e planit të saj të veprimit.

Aktualisht rekrutimi i bazuar në meritë për shërbyesit civilë rregullohet nga Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për Pagat e Shërbyesve Civilë, që të dy të miratuar në vitin 2010, dhe me disa akte nën-ligjore të miratuara më pas.²³ Më të fundit përfshijnë rregullore që adresojnë aspektet e rekrutimit, ngritjes në detyrë, kodit të mirësjelljes, pagave dhe kompensimeve, trajnimit, klasifikimit të pozitave, dhe dy strategji reformash me qëllim të mundësim-it të shërbim civil profesional dhe politikisht neutral.²⁴ Gjithsesi, zbatimi mbetet i dobët, më saktësisht rekrutimi i bazuar në meritë dhe promovimi nuk zbatohen sistematikisht.²⁵ Kjo e thënë, të gjitha këto rregullore sjellin rezultate të dobëta në praktikë për shkak që zbatohen vetëm formalisht ndërsa reflektohen kryesisht në kornizat legjislative dhe të politikave. Këtë pikëpamje e mbështet edhe këshilltarja për sundim të ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës e cila e nënvizon se “rekrutimi në shërbimin civil mbetet i politizuar”, kështu që një përkushtim shtesë ndaj reformave është i detyrueshëm për një zbatim me të lehtë.²⁶ Në raportin për vendin të vitit 2016, janë identifikuar një listë e gjatë e sfidave për implementimin e një shërbimi civil të bazuar në meritë, të tilla si mungesa e trajnimeve për të gjithë shërbyesit civilë, mungesë e zbatimit sistematik të vlerësimit të performacës, influencë e gjerë mbi emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të lartë dhe të ngjashme.²⁷ Në një përpjekje për të tejkaluar problemet sistematike aktuale. Ministria e Administratës Publike ka sponsorizuar ri-hartimin e këtyre ligjeve që nga 2012. Procesi i ri-hartimit i këtyre dy ligjeve ka kaluar afatin kohor të Komisionit Evropian, SIGMA poashtu ka vërejtur që finalizimi i këtyre draft ligjeve është kritik për përmirësimin e shërbimit civil, dhe si i tillë duhet të prioritetizohet.²⁸ Kjo vonesë është justifikuar në bazë të asaj se këto ligje janë duke u hartuar jo vetëm në pajtueshmëri me standardet dhe legjislacionin e BE-së por poashtu duke u bazuar në provat, analizat, mësimet e mësuara dhe kontekstin e vendit.²⁹ Në përgjithësi, sistemi i karrierës i bazuar në meritë për shërbyesit civilë përfaqëson një punë të vonuar në procesin i cili kërkon përkushtim të mëtejshëm politik përse i përket prioritetizimit të reformave.

TË DREJTAT THEMELORE: REGJISTRIMI I TË DHËNAVE PËR ADRESIMIN E FRIKËSIMIT TË MEDI-AVE; SULMEVE NDAJ GAZETARËVE; PAVARËSISË SË MEDIAVE

Dy sfidat kryesore të identifikuar në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve janë a) mungesë e hetimeve të thella nga sistemi i drejtësisë në lidhje me sulmet fizike dhe b) efikasiteti i ulët i gjykatave që japin vendimin përfundimtar në lidhje me këto raste.³⁰ Fakti më frikësues është numri i rritur i sulmeve fizike ndaj gazetarëve në dy vitet e fundit.³¹ E njëjta pikëpamje mbahet nga ish-drejtori i asociacionit të mediave i cili nënvizon se përse i përket sigurisë fizike të gazetarëve situata ka qenë shumë më mirë para vitit 2015 dhe së fundmi është përkeqësuar. Ndërsa përse i përket sigurisë ekonomike situata vazhdon të jetë e njëjtë, e varfër, shton ai.³² Për më tepër, mungesa e pronësisë së mediave vazhdon të jetë problematike, veçanërisht në lidhje me disa media online.³³ Që të dy këto

23 Ligji për Shërbimin Civil i republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149. (2010) Gazeta Zyrtare. Republika e Kosovës. Ligji për Pagat e Shërbyesve Civilë të Republikës së Kosovës. Nr. 03-L-147. (2010) Gazeta Zyrtare. Republika e Kosovës

24 Rregullorja Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes së Shqrbyesve Civilë të Republikës së Kosovës. Gjetet në [https://map.rks-gov.net/getattachment/cecdff8d-1f9e-448c-809e-a90a0d4f2ff5/RREGULLORE-\(QRK\)-NR-04-2015-PER-KODIN-E-MIRESJELLJ.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/cecdff8d-1f9e-448c-809e-a90a0d4f2ff5/RREGULLORE-(QRK)-NR-04-2015-PER-KODIN-E-MIRESJELLJ.aspx)

Rregullorja Nr.06/2012 për Pozitat Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Gjetet në: <https://map.rks-gov.net/getattachment/c8a9d54a-a15a-4da4-8398-23402ce80b7d/RREGULLORE-PER-POZITAT-E-LARTA-DREJTUESE-NE-SHERBLI.aspx>

Rregullorja Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Shërbyesve Civilë të Republikës së Kosovës. Gjetet në: <https://map.rks-gov.net/getattachment/e2d5d55e-0c2f-4abe-adbf-4b0edc89cd17/PER-AVANCIMIN-NE-KARRIERE-TE-NEPUNESVE-CIVILE.aspx>

Rregullorja Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Shërbyesve Civilë të Republikës së Kosovës. Gjetet në: <https://map.rks-gov.net/getattachment/e2d5d55e-0c2f-4abe-adbf-4b0edc89cd17/PER-AVANCIMIN-NE-KARRIERE-TE-NEPUNESVE-CIVILE.aspx>

Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës. Gjetet në: <https://map.rks-gov.net/getattachment/0c04c26e-fa07-4d6c-b35a-da738527e325/PER-SHTESAT-NE-PAGE-DHE-KOMPENSIME-TE-TJERA-TE-NEP.aspx>

Rregullorja Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve të Performancës së Shërbyesve Civilë të Republikës së Kosovës. Gjetet në <https://map.rks-gov.net/getattachment/d5cd6705-10c1-4b02-a6e1-3cd12c76ed67/RREGULLORE-NR-19-2012-PER-VLERESIMIN-E-REZULTATEVE.aspx>

25 Intervistë me Drejtorin e Zyrës Ligjore, Ministria e Administratës Publike. 18 Janar 2018

26 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit në Ambasadën e Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.

27 Komisioni Evropian. (2016). Raporti mbi vendin për Kosovën.

28 SIGMA (2017). “Raporti monitorues i 2017t: Parimet e Administratës Publike në Kosovë”

29 Intervistë me Drejtorin e Zyrës Ligjore, Ministria e Administratës Publike. 18 Janar 2018

30 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (2016). “Raport mbi treguesit për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve”

31 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.

32 Intervistë me ish-drejtorin e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Shkelqim Hysenaj. 19 Janar, 2018. Sipas tij, përse i përket sigurisë ekonomike situata vazhdon të mbetet e njëjtë, gazetaret kanë paqë dhe kontrata të vogla; gjithsesi, kur ka shkelje të kontratës nga media, inspektorati nuk i zbaton kushtet e kontratës.

33 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (2016). “Treguesit për liri të mediave dhe sigurisë së gazetarisë”

fakte kanë vazhduar që t'i bëjnë gazetarët që të ndihen jo të sigurtë në lidhje me perspektivën e raportimit. Si për sfidat e identifikuar, raporti i fundit mbi vendin ka rekomanduar që rastet e sulmeve fizike kundër gazetarëve dhe të formave të tjera të presionit hetohen dhe gjykohen shpejt. E vetmja arritje në lidhje me këtë mekanizëm vlerësues është përzgjedhja e një prokurori në çdo prokurori themelore që të merret, dhe kështu të prioritetizojë rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.³⁴ Për më tepër korniza ligjore në lidhje me mediat është forcuar në vitin 2014 nga Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë i miratuar në vitin 2013 i cili i lejon gazetarët që të mbrojnë burimet, edhe në një procedurë penale.³⁵

Një nga problemet kryesore me pavarësinë e mediave e theksuar në secilin raport për vendin është qëndrueshmëria afat-gjate financiar e transmetuesve publikë. KE-ja ka kërkuar qartësisht nga qeveritë që të sigurohet një situatë e qëndrueshme financiare për transmetuesit publikë më qëllim që të kufizohet influenca politike dhe të sigurohet pavarësia editoriale. Ky kusht i cili vazhdon të ekzistojë është neglizhuar deri tani: Sigurisht që rekomandimet vazhdojnë të përsëriten, edhe kjo me të njëjtat fjalë, përderisa ato nuk janë zbatuar.³⁶

TË DREJTAT THEMELORE: ZBATIMI I LIGJIT PËR NDALIM TË DISKRIMINIMIT

Në vitin 2015 Kosova miratoi të ashtuquajturën "Paketa e Ligjeve për të Drejtat e Njeriut" për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e individëve, përfshirë dispozitat kundër diskriminimit dhe barazisë gjinore. Një nga tre ligjet e miratuara ishte Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ligji i miratuar rrjedh si një kusht nga Udhërrëfyti për Liberalizim të Vizave me Kosovën, i cili ka kërkuar miratimin dhe zbatimin e legjislacionit i cili i referohet mbrojtjes efektive kundër diskriminimit si dhe për respekt të plotë të dispozitave vendore për të Drejtat e Njeriut. Me qëllim që të sigurohet një zbatim i plotë i ligjit, në vitin 2016, është miratuar gjithashtu rregullorja për mekanizmat institucionalë për mbrojtje kundër diskriminimit në qeveri dhe komuna.³⁷ Miratimi i kësaj rregulloreje ka çuar në krijimin e departamentit për mbrojtje kundër diskriminimit në kuadër të institucionit të Ombudspersonit. Ende dy vite pas miratimit të ligjit, zbatimin aktual i tij mbetet mbrapa.³⁸

Problemi kryesor që paraqet Ligji është pra izolimi i tij relativ në kuadër të sistemit të gjerë ligjorë.³⁹ Sipas Ombudspersonit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mungesë harmonizimi ligjorë me ligjet e tjera dhe një pavarësi të ulët në praktikë, që të dyja këto e pengojnë zbatimin e ligjit. "Paketa ligjore për të drejtat e njeriut është hartuar me ndihmën e gjashtë ekspertëve ndërkombëtarë të cilët e neglizhuan harmonizimin jo vetëm të paketës ligjore, por poashtu me ligjet e tjera në praktikë."⁴⁰ Më saktësisht, Ligji për Mbrojtje ndaj Diskriminimit ka shtrirë mandatin e Ombudspersonit edhe në sektorin privat, duke krijuar një mospërputhje për faktin që Kushtetuta e Republikës së Kosovës e kufizon atë vetëm në sektorin publik. Për më tepër, ligji synon të "themelojë një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit" bazuar në një rang të gjerë shkaqesh, në mesin e të cilëve kombësia. Feja, seksi dhe madje përfshihen edhe gjinia dhe identiteti gjinor. Përderi sa nuk përfaqëson një numër klauzolash, por një listë të hapur, këto klauzola mund të lexohen vetëm si orientuese dhe jo përfundimtare.⁴¹ Në përgjithësi, në praktikë ka mbrojtje të mangët nga diskriminimi për shkak të mospërputhshmërive, kontradiktave dhe keqinterpretimeve të ligjeve të miratuara.

AZILI: BASHKËRENDITJA E LIGJIT TË AZILIT ME ACQUIS-NË E BE-SË

Kosova e ka bashkërenditur shumicën e legjislacionit të saj me Acquis-në e BE-së dhe standardet ndërkombëtare në fushën e azilit. Kërkesat për të miratuar një ligj për azilin rrjedh nga Udhërrëfyti për Liberalizimin e Vizave në vitin 2012. Raporti i fundit i KE-së nënvizon poashtu që marrëveshjet e ri-pranimit me Vendet anëtare të BE-së dhe vendet e Asociuara të Shengenit janë duke u zbatuar progresivisht. Holanda është e kënaqur me zbatimin dhe bashkëpunimin e saj. Më tej, duke marrë parasysh faktin që ka pasur vetëm një kërkesë azili vitin e kaluar,

34 Intervistë me ish-drejtorin e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Shkelqim Hysenaj. 19 Janar, 2018.

35 Law Nr.04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë. Gjetet në <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf>

36 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. 31 January 2018.

37 Rregullorja No.03/2017 për Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtjen kundër Diskriminimit në Qeveri dhe Komuna. Gjetet në://ëëë.kryeministrits.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK_-_NR_03_2017_P%C3%8BR_MEKANIZMAT_INSTITUCIONAL_P%C3%8BR_MBROJTJE_N....pdf

38 Garcia Martinez, F. J. dhe Cucchi, U. (2018). "Një sistem i përdorur pak: Gjendja aktuale e kornizës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë" Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Alalizë Ligjore. Në Proces të publikimit.

39 Garcia Martinez, F. J. dhe Cucchi, U. (2018). "Një sistem i përdorur pak: Gjendja aktuale e kornizës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë" Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Alalizë Ligjore. Në Proces të publikimit.

40 Intervistë me Ombudsperson, Hilmi Jashari. 22 Janar, 2018.

41 Garcia Martinez, F. J. dhe Cucchi, U. (2018). "Një sistem i përdorur pak: Gjendja aktuale e kornizës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë" Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Alalizë Ligjore. Në Proces të publikimit.

Shpjegim: leximi i ligjit nuk mund të jetë kufizues. Duhet të merren parasysh edhe burime tjera të diskriminimit, edhe pse nuk janë përmendur në mënyrë eksplite në dokument.

nuk mundet që dikush ta vlerësojë siç duhet Kapacitetin institucional për të vlerësuar kërkesat e azilit dhe për të ofruar strehë kërkuesve të azilit.⁴² Gjithsesi, gjatë tre viteve të fundit autoritetet kanë treguar vullnet për të zbatuar rekomandimet në lidhje me politikën e azilit.⁴³ Janë miratuar poashtu edhe dy rregullore tjera; një për Procedurat dhe Standardet për Shqyrtimin dhe Vendim-marrjen mbi Kërkesat për Azil dhe një për Procedurat dhe Standardet për Pranim dhe Trajtim Fillestar të Kërkesve të Azilit.⁴⁴ Për më tepër, Raportet e KE-së kanë nënvizuar që trajnimi i stafit në lidhje me kapacitetet e tyre për të vlerësuar kërkesat për azil do të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që ligji të zbatohet plotësisht.

KUFIJTË E JASHTËM DHE SHENGENI: PLANE SPECIFIKE KUNDËR-KORRUPSIONIT; OFRIMI I NDJEKJES ADEKUATE TË RASTEVE TË ZBULUARA; BASHKËPUNIM NË KUFIJ.

Mekanizmat vlerësues për Kufijtë e jashtëm rrjedhin që nga Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave në vitin 2012. Ndryshe nga mekanizmat e tjerë vlerësues që rrjedhin nga Raportet mbi Vendin, shumica e mekanizmave vlerësues për kufijtë e jashtëm dhe Shengenin ishin specifik dhe të matshëm.⁴⁵ Sipas përfaqësuesit të OShC-së, këto mekanizma vlerësues specifikë kanë qenë efektivë dhe ka qenë më e lehtë që të monitorohet dhe raportohet për plotësimin e këtyre standardeve të përcaktuar nga mekanizmat vlerësues.⁴⁶ Kushtet që mbeten për t'u përmbytur përfshirë edhe "demarkacionin" me Malin e Zi (bashkëpunimi në kufij) dhe vendime përfundimtare nga gjykata në lidhje me krimin e organizuar (vijueshmëri/ndjekje e rasteve të zbuluara) janë ende në proces. Zgjatja e procesit në lidhje me këto kushte është kryesisht për shkak të dy faktorëve kryesorë: mungesa e vullnetit politik dhe mungesa e stabilitetit politik. I pari i referohet influencës së panevojshme politike, ndërsa i dyti i referohet ngërçit politik gjashtë muaj të vitit 2014⁴⁷ dhe atij të zgjedhjeve të fundit të Qershorit 2017, i cili i mori katër muaj negociata derisa u formua qeveria e re.⁴⁸ Perceptimi i përgjithshëm është se situata do të ndërrojë më në mënyrë drastike në mënyrë që kushtet që mbeten të përmbyshen.

LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR: ROLI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS DHE I MEKANIZMAVE MBIKËQYRËS NË FUNKSION; REGJISTRIMI I TË DHËNAVE FILLESTARE PËR HETIMET E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Lufta kundër krimit të organizuar është renditur si prioritet kryesor në aspektin e reformave në procesin e zgjerimit. Mekanizmi vlerësues në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar mund të gjurmohet në kohe që me udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave në vitin 2012. Për sa i përket MSA-së së nënshkruar, nevojitet që Kosova të ketë një kornizë funksionale legjislativë kundër-korrupsionit, të shoqëruar me politika dhe institucione për zbatimin e saj. Vendi e ka një legjislacion funksional kundër korrupsionit, por mungojnë rezultate konkrete kundër korrupsionit të organizuar.⁴⁹ Numri i rasteve komplekse të krimit të organizuar që përfundojnë me vendime përfundimtare është i ulët dhe numri i pasurive të sekuestruar dhe të konfiskuara të urdhëruara nga gjykata dhe ekzekutuar nga policia mbetet i ulët. Gjatë tre viteve të fundit, BE-ja ka kërkuar konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurive dhe dënime përfundimtare për shkelësit e ligjit. Kjo e thënë, BE-ja ka kërkuar që të ndërtohet një regjistrim i të dhënave në luftën kundër krimit të organizuar. Raporti për Vendin i vitit 2016 ka regjistruar me të dhënat e regjistruara për luftimin e krimit të organizuar, përfshirë rastet e profilit të lartë, është operacional. Me vonë, Komisioni ka kërkuar një mekanizëm gjurmues jo vetëm për rastet e profilit të lartë, por një i cili do të përfshinte të gjitha rastet penale. Kjo e thënë, bashkëpunimi ndër-institucional dhe shkëmbimi i informacionit në mesin e institucioneve të sundimit të ligjit mund të rritet. Bashkëpunimi në mesin e aktorëve të sundimit të ligjit është një lloj veprimi kyç dhe që përsëritet i cili kërkohet nga KE në luftën kundër krimit të organizuar. Operimi i vazhdueshëm i regjistrimit dhe përditësimi i tij me informacione të regjistrimit fillestar është i detyrueshëm për përparimin e standardit të përcaktuar në mekanizmin vlerësues në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar.⁵⁰ Në përgjithësi lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë mbetet një punë në progres e sipër e cila kërkon vullnet politik për të prioritetuar reforma.

42 Intervistë me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.

43 Intervistë me Plator Avdiu, Qendra Kosovare për Studime Sigurie. 02 Janar 2018.

44 Udhëzimi Administrativ Nr17/2013 për Procedurat dhe Standardet për Shqyrtimin dhe Vendim-marrjen në lidhje me Kërkesat për Azil. Udhëzimi administrativ

45 Intervistë me Albana Merja, Kolege hulumtimi. Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. 15 Janar, 2018.

46 Merja, A. (2013). "Procesi i Liberalizimit të Vizave në Kosovë: Një matrisë vlerësuese e Arritjeve dhe Sfidave (Raporti vlerësues i tretë). Shënim politikash. Grupi për Studime Ligjore dhe Politike.

47 Kallxo, "KQZ Shpalli Rezultatet Përfundimtare të 8 Qershorit" 26 June, 2014 Available at <http://kallxo.com/gjnk/kqz-shpalli-rezultatet-perfundimtare-te-8-qershorit/> Kallxo, "Isa Mustafa, Kryeministër i Kosovës" 09 December, 2014. Gjindet në <http://kallxo.com/isa-mustafa-kryeminister-i-kosoves/>


48 Zeri, "Votohet Qeveria, Ramush Haradinaj sërish kryeministër" 09 September, 2017. Gjindet në <http://zeri.info/aktuale/161243/votohet-qeveria-ramush-haradinaj-serishkryeminister/>

49 Rexha, A. (2016) "Përcaktimi i konfiskimit të pasurisë nga krimi: Një rast skenar rasti statistikor" Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. Shënim Politikash. Rexha, A. (2015) "Përcaktimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme: Sfidat dhe perspektiva e qasjes së Kosovës" Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. Analizë Politikash.

50 Intervista me Venera Ramaj, Këshilltare Politike për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. 31 Janar 2018.



DISKUTIMI I REZULTATEVE



Tetë mekanizmat vlerësues për përcaktimin e standardeve janë rishikuar në mënyrë kritike për të adresuar nivelin e tyre të zbatimit dhe shtrirjen deri në çmasë janë zgjidhur problemet e shënjestruara. Për këtë qëllim, të dhënat në lidhje me secilin mekanizëm vlerësues është gjurmuar mbrapa në kohë që nga viti 2012 në një numër dokumentesh për zgjerim. Për më tepër, janë zhvilluar shumë intervista me bashkëbisedues relevantë.

Rezultatet prezantojnë një punë në progres me rezultate fillestare të arritura dhe punë që mbetet për t'u bërë. Me fjalë më konkrete, korniza legislative është në funksion për shumicën e mekanizmave vlerësues; gjithsesi, zbatimi është i dobët. Argumentimi i përdorur nga shtetet anëtare të BE-së për një "përputhshmëri simbolike dhe/ose kreative" në mënyrë që të ilustrojnë veten e tyre me një sjellje konform-normave por pa u dorëzuar para objektivave të tyre fillestare duket të jetë e vërtetë edhe në rast të vendeve për zgjerim si Kosova.⁵¹ Kjo e thënë, mund të vërehet se boshllëku ndërmjet përkushtimeve formale të bëra nga elita politike dhe praktikat jo-formale mbetet një sfidë për vendin.

Një përfaqësues nga shoqëria civile nënvizon se kërkesat që dalin nga Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave janë specifike, sidomos në krahasim me rekomandimet e tjera që dalin nga raportet mbi vendin. Kjo e thënë, ato ishin efektive dhe që monitorohen lehtë.⁵² Një përfaqësues tjetër nga shoqëria civile është i shqetësuar me përgjithësinë e disa mekanizmave si luftimi i krimit të organizuar. Ky mekanizëm vlerësues nuk është specifik dhe lë hapësirë për (keq)interpretime subjektive të arritjeve nga partitë politike në fuqi.⁵³ Nga ana tjetër, këshilltarja për sundim të ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës thekson se "mekanizmat janë mjaftueshëm specifik, që të mund të zbatohen".⁵⁴ Ajo shton se mekanizmat vlerësues të KE-së janë formuluar jo vetëm në pajtueshmëri me "bazat themelore së pari" të KE-së, por poashtu edhe në pajtueshmëri me kontekstin dhe sfidat e vendit.

Në përgjithësi analiza na paraqet që qeveria e Kosovës preferon që t'iu përkushtohet vetëm në mënyrë sipërfaqësore mekanizmave vlerësues të përzgjedhur ndërsa miraton legjislacione në përputhje me recetat e BE-së por duke i rezistuar zbatimit të rregullave të miratuara. Prandaj, KE-ja duhet të marrë parasysh pikat në vijim:

- që t'i bëjë mekanizmat vlerësues më specifikë ndaj nevojave të kontekstit të vendit
- të kërkojë mekanizma vlerësues të detajuar dhe eksplicitë në luftën kundër krimit të organizuar⁵⁵
- të projektojë mekanizmat vlerësues në mënyrë të tillë që të mbajnë nën vëzhgim qeverinë në baza të rregullta dhe të vazhdueshme
- të reflektojë në mënyrë substanciale rekomandimet e shoqërisë civile në këto mekanizma vlerësues.

51 Batory, A. (2016). "Defying the Commission: Creative Compliance and Respect for the Rule of Law in the EU" Gazeta e Administratës publike.

52 Intervistë me Venera Ramaj, Këshi i lartë politik për Sundim të Ligjit e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës . 31 Janur 2018.

53 Intervistë me Albana Merja, kolege hulumtimi. Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. 15 Januar, 2018.

54 Intervistë me Plator Avdiu, Kosovo Center for Security Studies. 02 January 2018.

55 Shpjegim: Jo vetëm kërkesat për përkushtim dhe politika për tolerancë zero drejt luftës kundër korrupsionit, por kërkesë që të ndërmerren masa specifike për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin si hartimi i një rekomandimi specifik me një theks në krimet që lidhen me përfshirjen e aktorëve politikë

ANEKSI 1

Mekanizmi vlerësues [xxx]

[Shteti]

Data e krijimit:	[dd.mm.viti]
Nga:	[Organizata]

0. Bazat e benchmark	
Metoda e prezantimit <i>[p.sh., përcaktuar në dokumentin...]</i>	
Viti i prezantimit	
Përmbajtja e mekanizmit vlerësues dhe veprimet që kërkohen <i>[Lutemi listoni veprimet e nevojshme si pika sipas raportit/dokumentit specific të fundit të KE-së]</i>	
Lloji i mekanizmit vlerësues dhe veprimet që kërkohen <i>[P.sh., Miratimi i një dokumenti politikash (Pol); Miratimi i legjislacionit (Leg); zbatimi; etj.]</i>	
1. Analiza e të dhënave/metodologjia	
Dokumentet që duhen analizuar <i>[punë kërkimore, psh. Raportet e KE-së; raportet e OSBE-së; raportet e veta të monitorimit-lutemi vendosni edhe adresën në internet të çdo dokumenti]</i>	
Intervista <i>[Numri i intervistave dhe lloji i të intervistuarit]</i>	
Fokus grupe <i>[nëse ka]</i>	

<p>Konstatimet e treguesve sasiorë</p> <p><i>[Këtu janë futur treguesit për secilën nga mekanizmat vlerësues - duke qenë se do të plotësojmë një model të veçantë për secilin mekanizëm vlerësues, fshini rreshtat e mekanizmave vlerësues që nuk plotësoni dhe në mënyrë të përshtatshme kopjoni e vendosni rreshtat për secilën nga mekanizmat vlerësues në modelin e tyre të veçantë të përshtatshëm - në fund duhet të keni 8 modele identike në të cilat ndryshimi i vetëm është ky seksion. Në këtë aspekt, vini re se kemi marrë të njëjtit tregues për dy kriteret në fushën e gjyqësorit.]</i></p>	<p>Sistem karriere i bazuar në meritë për gjyqtarët</p> <p>Reformat në akademinë gjyqësore</p>	<p>Freedom House - Kombet në Tranzit</p> <p>Pikët për Kuadrin dhe Pavarësinë e Gjyqësorit <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për 3 vitet e fundit)</i></p> <hr/> <p>Barometri i Ballkanit –</p> <p>Figura 86: A mendoni se institucionet e mëposhtme janë të pavarura nga ndikimi i politikës? (sipas ekonomive)</p> <p>(PYETJE E RE) <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për këtë vit për gjyqësorin)</i></p> <p>Tabela 16: Sa jeni apo nuk jeni dakord se kategoritë e mëposhtme në ekonominë e vendit tuaj ndikohen nga korrupsioni?? (sipas ekonomive)</p> <p>(PYETJE E RE) <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për këtë vit për gjyqësorin)</i></p> <hr/> <p>Indeksi i Transformimit Bertelsmann -</p> <p>Shteti Ligjor – pavarësia e gjyqësorit</p> <p><i>(vendosni pikët për vendin tuaj për tre vitet e fundit)</i></p>
	<p>Sistem karriere i bazuar në meritë për nëpunësit civilë</p>	<p>Barometri i Ballkanit–</p> <p>Tabela 16: Sa jeni apo nuk jeni dakord se kategoritë e mëposhtme në ekonominë e vendit tuaj ndikohen nga korrupsioni?? (sipas ekonomive)</p> <p>(PYETJE E RE) <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për këtë vit)</i></p>
	<p>Prova për trajtimin e kërcënimit të medias; sulmet ndaj gazetarëve; pavarësia e medias</p>	<p>Freedom House - Kombet në Tranzit</p> <p>Media e pavarur - <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për tre vitet e fundit)</i></p> <p>Freedom House – Pikët për lirinë e shtypit</p> <p>Totali i pikëve; mjedisi ligjor, politik dhe ekonomik <i>(vendosni pikët për vendin tuaj për tre vitet e fundit)</i></p>
	<p>Zbatimi i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”</p>	<p>Rrjeti Evropian i Ligjit për Barazinë –</p> <p><i>(Burimi për Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Pjesa tjetër e vendeve: Kosova, Bosnje-Hercegovina, dhe Shqipëria lutemi fusni referencën përkatëse gri të literaturës</i></p>
	<p>Ligji për azilin i përafuar me acquis të BE-së</p>	<p>Gjetjet nga intervistat dhe raportet e progresit të KE-së nga tre vitet e fundit</p>
	<p>Plane specifike anti-korrupsion; të ndiqen më tej deri në fund rastet e zbuluara</p>	<p>Gjetjet nga intervistat; kërkesë për informacion sipas ligjit për të drejtën e informacion si provë bindëse dhe raporti i progresit i KE-së</p>
<p>Roli i shërbimeve të inteligjencës dhe i mekanizmave të mbikëqyrjes që janë prezantuar; dhënia e provave të para bindëse për hetimin e krimit të organizuar</p>	<p>Gjetjet nga intervistat dhe raportet e progresit të KE-së nga tre vitet e fundit</p>	

2. Përmbledhje e gjetjeve

Kuadri kohor/zhvillimi i me-kanizmave vlerësues me kalimin e kohës

[Lutemi shtoni sa më shumë rreshta që të jetë e nevojshme në tabelë]

Ngjarja/Dokumenti/Lidhja	Viti

Shpjegim me fjalë i kuadrit kohor të mekanizmit vlerësues

[Lutemi shpjegoni shkurtimisht zhvillimin e benchmark me kalimin e kohës, orientuar nga informacioni që vendosët në tabelë]

Gjetjet kryesore për zbatimin dhe monitorimin e mekanizmit vlerësues

[Lutemi jepni një vlerësim kritik dhe përfshini edhe gjetjet nga intervistat/puna kërkimore/ ekspertiza e organizatës – vendosni referencat në këtë proces]

Gjetjet kryesore për efektivitetin e mekanizmit vlerësues

[Lutemi jepni gjetjet nga intervistat si dhe gjetjet nga treguesit sasiorë të shoqëruar me një vlerësim kritik - vendosni referencat në këtë proces]

Sfidat kryesore për zbatimin/efektivitetin e mekanizmit vlerësues

[Renditini shkurtimisht me pika]

Tendencat e vëzhguara

[Përshkruajini shkurtimisht me dy fjali]

3. Rekomandimet

Rekomandime për forcimin e mekanizmit të monitorimit/efektivitetit të mekanizmit vlerësues

[Renditini shkurtimisht me pika; shtoni rreshta nëse është e nevojshme]

Për qeverinë/institucione të veçanta

Për Komisionin Evropian

4. Përfundimet

[Lutemi përshkruani shkurtimisht përfundimet e gjetjeve tuaja në lidhje me mekanizmin vlerësues në fjalë.]